



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:283216

Datë: 22.02.2021

Numri i dokumentit: 01524526

**P.nr. 1121/19**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, me gjyqtarin Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit, K. K., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par. 2 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.nr.1336/19 të datës 29.11.2019, mbajti seancën publike të shqyrtimit fillestar, me dt. 25.01.2021, në prezencë të Prokurorit të shtetit Muharrem Bajraktari, të pandehurit K. K. dhe mbrojtësit të tij Av. Gëzim Kollçaku sipas autorizimit, me dt. 28.01.2021 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.22.02.2021, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri

**K. K.**, i biri i A. dhe nënës S. e gjinisë S., i lindur me dt. .... në ....., me vendbanim në ..... rr. ”.....” p.nr., identifikohet në bazë të lnj.nr. personal ....., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion kamarier, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. tel. ...., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse,**

- Me pare e gjere me date 12.06.2019, rreth orës 21:40, në ..... në rr.”.....” në lokalën e marr me qera të tipit “.....”, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete e në kundërshtim me nenin 1 të Ligjit nr. 06/L-155, organizon lojëra të fatit për të cilën nuk është dhënë licenca nga organi kompetent në atë mënyrë që ditën kritike pasi policia kishte marrë informacion se në lokalën e lartcekur zhvillohen lojërat e ndaluara të fatit, pas kontrollit ka hasur në dy aparate të llojit ....., një lloj-top në funksion të lojërave të fatit dhe dy televizor-monitor aktiv në momentin e kontrollit.

- me çka ka kryer veprë penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit te paligjshëm nga neni 294 par. 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 38, 42, 43,44, 69, 70, 71 par.1, nën par. 1.3, neni 294 par. 2 të KPRK-së dhe nenin 115 par 2 nenpar 2.2, nenit 365 të KPP-së, të pandehurin:

## **E G J Y K O N**

- Dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, dënimi me burg me pëlqimin e te pandehurit i është zëvendësuar me dënim me gjobë ne shumen prej 700 (shtatëqind) euro, e te cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afatit prej 6 (gjashtë) muaj pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.
- Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.
- I pandehuri obligohet në pagimin e paushallit gjyqësor shumen prej 20 (njëzetë) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit i –KONFISKOHET- llop-topi i llojit ....me numer serik ....class.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.1336/19 te datës 29.11.2019, kundër të pandehurit K. K., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit te paligjshëm nga neni 294 par. 2 të KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 25.01.2021, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar, prezentë kane qene prokurori i shtetit i pandehuri dhe mbrojtësi i te pandehurit sipas autorizimit.

Gjykata konform dispozitave te nenit 248 par.5 të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta dhe ka shtuar se për mbrojtës ka angazhuar avokatin Gëzim Kollqaku sipas autorizimit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësi të pandehurit qe të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

I pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë , ka shprehur pendimin për veprën e kryer dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Mbrojtësi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pas konsultimit me te mbrojturin e tij dhe pasi qe i njëjti i kuptoj te gjitha privilegjet dhe kufizimet qe rrjedhin nga pranimi i fajësisë, ne seancën e sotme, ashtu siç edhe ne procedurën parapenale dhe ne prokurori beri pranimin e fajësisë, andaj i propozon gjykatës qe këtë pranim edhe gjykata ta pranoje si pranim te vullnetshëm. Duke pasur parasysh dispozitën ligjore te nenit 246 par. 4 te KPPK-së ku është rregulluar se pas pranimit të fajësisë nuk është e nevojshme ti ipet fjala përfundimtare , ai si mbrojtës deklaroi se pranimi i fajësisë nga gjykata te konsiderohet si rrethane posaqarisht lehtësuese ashtu siç shihet me nenin 71 te KPPK-së si dhe te merren parasysh pendimi i thellë i te mbrojturit te tij, premtimi se ne te ardhmen nuk do te përsërisë veprën penale, faktin se i njëjti këtë veprimtari e ka ushtruar vetëm tri ditë, gjithashtu i mbrojturi i tij asnjëherë me pare nuk ka ra ndesh me ligjin , si dhe sjelljen korrekte te njëjtit e qe kjo gjykate duke marr parasysh te gjitha këto rrethana posaqarisht lehtësuese ta zbatoje nenin 72 te KPPK-së qe kemi te bëjmë me zbutjen e dënimit nen kufijtë e dënimit dhe te njëjtit ti shqiptoje një dënim me gjobe apo dënim te kushtëzuar e qene me këtë dënim me siguri do te arrihet qëllimi i dënimit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, ka marrë mendimin nga Prokurorit të Shtetit, ku prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet së është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës. Gjykatës i propozon që ta pranon pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit dhe të merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi qe i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti i hetuesit policor A. B. #5200 i datës 12.06.2019, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve e datës 12.06.2019, vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm te sendeve e datës 13.6.2019, deklarata ete dyshuarit K. K. e dhënë ne Stacioni Policor ne Pejë me datë 13.06.2019, procesverbali i Doganës se Kosovës për konfiskimin e aparateve, procesverbali i Inspektoratit Komunal te Tregut, dëftesa mbi konfiskimin e te hollave ne vlere prej 235 euro, raporti i ekspertimin AKF-2019-0221i datës 14.10.2019, si dhe shkresat tjera te lendes, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit Medin Gashi, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, legalizimi i përmbajtjes se rreme nga neni 403 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i parket fajësisë i pandehuri ishte i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori pranimin e fajësisë, pendimin për veprën e kryer, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, po ashtu si rrethana lehtësues gjykata mori faktin se i njëjti me parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale dhe ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedure tjetër penale, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Konform nenit 43 par 3 të KPRK-së, nëse i pandehurit nuk e paguan dënimin me gjobë, gjykata do të zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burg ku një ditë burg do ti llogaritet për 20 euro gjobë.

Vendimin për konfiskimin e lloptopit të llojit ....me numer serik ....class, gjykata e mori konform nenit 115 par 2 nënpar 2.2 të KPP-së, pasi që gjykata vlerësoj se ky lloptop ka shërbyer si mjet për kryerjen e kësaj vepre penale. Ndërsa gjykata nuk ka konfiskuar parat e sekuestruar përkohësisht nga i pandehuri në vlerë prej 235 euro, pasi që ne shkresat e lëndës nuk ka prova se ketë para janë dobi pasurorë e fituar me kryerjen e veprës penale

Duke u bazuar në nenin 450 par 2 nën par 2.6 të KPP-së, e obligoi të pandehurin në pagimin e paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të pandehurin që të paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr.1121/19, dt. 22.02.2021**

**Bashkëpunëtore profesionale**  
Selvane Bukleta

**GJYQTARI**  
Shaqë Curri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.